Sukses i shkëlqyer në garat komunale të volejbollit!

Sot, në sallën sportive "Sabedin Bajrami", u zhvilluan garat komunale të volejbollit për vajza, për klasat VII-IX, ku nxënëset e shkollës sonë treguan lojë të shkëlqyer, përkushtim dhe frymë të vërtetë ekipore.

Vendi i parë - shkolla jonë!

Me paraqitjen e tyre të shkëlqyer, vajzat tona arritën të shpallen kampione të garave komunale, duke dëshmuar talentin, punën dhe bashkëpunimin e tyre në fushën e lojës.

Vendin e dytë - shkolla e Pirokut.

Berina Sinani - Lojtarja më e mirë!

Urime të gjithë nxënësve për këtë sukses të bukur, si dhe mësimdhënësve për angazhimin dhe përkushtimin e tyre! Krenari për shkollën tonë! Suksese të tilla janë dëshmi se puna, disiplina dhe bashkëpunimi sjellin rezultate.



